

Ushtrimi i ndikimit ndaj gazetarëve në

Kosovë

*Hyrë Tejeci**

Abstrakti

Debatet lidhur me lirinë e medias nuk kanë shteruar kurrë, gjatë gjithë historisë së medias, së shkruar e elektronike. Por, në periudha të ndryshme të historisë së saj, kufizimet e lirisë së shtypit janë shprehur më pak ose më shumë, në mënyrë më të vrazhdë apo në mënyrë më të butë, varësisht prej zhvillimeve shoqërore, politike, ekonomike, kulturore, etj.

Kureshtja profesionale më ka nxitur të bëj një hulumtim lidhur me përmasat reale të ndikimit dhe me format e ushtrimit të ndikimit ndaj gazetarëve e redaksive në Kosovë. Të dhënat e pyetësorëve tregojnë se ushtrimi i ndikimit ndaj gazetarëve është më i madh se sa perceptioni i jashtëm.

Nëpërmjet pyetësorit jam përpjekur të kuptoj edhe format e ndikimit dhe mënyrën e ushtrimit të tij. Nga përgjigjet del se ndikimi ndaj gazetarëve ushtrohet në mënyrë direkte apo indirekte, në formë të fortë (në trajtë të urdhëresës) apo në formë të butë (në trajtë të këshillës apo rekomandimit).

Fjalë kyçe: *hulumtimi, ushtrimi, ndikimi, gazetarë, Kosovë*

Hyrje

E drejta për lirinë e shprehjes përfshinë lirinë për të kërkuar dhe për të marrë informacion. Ky është një komponent kyç i qeverisjes demokratike. Liria e medias kërkohet edhe me kriteret e Kopenhagës për anëtarësim në Bashkimin Evropian.¹ Në Kosovë ka pasur shpesh diskutime e debate lidhur me lirinë e medias dhe lidhur me ndikimet ndaj medias. Diskutimet e debatet e kësaj natyre janë zhvilluar prej rastit në rast, më shumë në bazë të perceptonit ose në bazë të rasteve konkrete.

* Hyrë Tejeci, MSc, Universiteti AAB, Prishtinë, htejeci@hotmail.com

¹ Council of the European Union, EU Human Rights Guidelines on Freedom of Expression Online and Offline, Bussel, may 2014,

Raportet e organizatave ndërkombëtare që merren me lirinë e shtypit dhe me mbrojtjen e gazetarëve nxjerrin në pah një të vërtetë të hidhur – gjendja e lirisë së shtypit vetëm sa është përkeqësuar, në shumë vende të botës.

Analizat dhe sondazhet tregojnë se edhe mediet në Kosovë sot, ku më shumë e ku më pak, përballen me forma të ndryshme të ndikimit, më së shumti nga pushteti, por edhe nga opozita dhe nga grupe të ndryshme të interesit.

Këtë e ka vërtetuar edhe hulumtimi im rreth ushtrimit të ndikimit ndaj gazetarëve. Rezultatet e hulumtimit tregojnë se gazetarët kosovarë sot përballen me ushtrim të drejtpërdrejtë e të tërthortë të ndikimit. Tutorë të gazetarëve shfaqen më së shumti përfaqësuesit e pushtetit ose titullarët dhe pronarët e medieve, të cilët e ushtrojnë ndikimin e tyre nëpërmjet menaxherëve ose redaktorëve të përzgjedhur prej tyre. Por, nuk janë të pakta as rastet e ushtrimit të ndikimeve nga individë apo grupe të ndryshme të interesit, zakonisht të afërta me pushtetin ose me pronarët dhe titullarët e medieve. Natyrisht, ka edhe raste të ushtrimit të ndikimit nga opozita.

Në këtë punim kam hulumtuar shkallën e lirisë së medieve në Kosovë dhe kufizimet që kanë gazetarët. Kam bërë një krahasim të censurës dhe vetëcensurës që ndodh te gazetarët. Edhe përgjigjet e pyetësorit e kanë treguar këtë. Po ashtu janë shpjeguar shkaqet dhe problemet që kanë gazetarët në kryerjen e punës së tyre. Me këtë punim jam përpjekur të nxjerr një të vërtetë më reale rreth lirisë së medias dhe kufizimeve që kanë gazetarët në Kosovë. Madje ka raste edhe të kërcënimeve të drejtpërdrejta të gazetarëve. Mbi 35 % të të anketuarve janë deklaruar se kërcënimet më të shpeshta i marrin përmes telefonit dhe në formë elektronike.

Ndërkaq, mbi 50 % thonë se kanë dilema nëse do ta vazhdojnë profesionin e gazetarisë, për shkak se ndjehen të rrezikuar nga presionet dhe kërcënimet që marrin. Hulumtimi im nxjerr në pah edhe dyshimin e arsyeshem në sinqeritetin e gazetarëve që u janë përgjigjur pyetjeve të shtruara në pyetësor, duke pasur parasysh frikën se ata mund të kenë pasoja për përgjigjet e tyre, ndonëse në pyetësor u është lënë e hapur mundësia që ta ruajnë anonimitetin e medias për të cilën punojnë.

Metodologjia e hulumtimit

Hulumtimi im është kryer në periudhën prill-maj të këtij viti (2015). Në të janë përfshirë 160 gazetarë të medieeve të ndryshme, elektronike e të shkruara, private e publike (Radiotelevizionit të Kosovës – RTK).

Objektiv i hulumtimit ka qenë përfshirja e të gjithë gazetarëve, por ky objektiv nuk është arritur, për arsye të ndryshme, sigurisht, objektive e subjektive.

Hulumtimi është realizuar nëpërmjet pyetësorit, i cili u është shpërndarë gazetarëve, të cilëve u është garantuar anonimiteti, me qëllim që të japin përgjigje objektive, jashtë çfarëdo ndikimesh e shqetësimesh nga jashtë. Hulumtimi është fokusuar në përcaktimin e përmasave të ushtrimit të ndikimit ndaj gazetarëve në redaksitë e tyre, në identifikimin e ushtruesve të ndikimit dhe të mënyrës së ushtrimit të ndikimit, si edhe në mënyrën e reagimit të gazetarëve ndaj ndërhyrjeve joprofesionale.

Për këtë arsye, në pyetësorë janë ofruar nga tri përgjigje, kryesisht opsionale: një përgjigje pozitive, një përgjigje negative dhe një përgjigje e ndërmjetme. Të anketuarve nuk u është ofruar mundësia të japin edhe ndonjë përgjigje tjetër jashtë tri përgjigjeve opsionale, nga droja se ato mund t'i nxirrnin nga fokusi objektivat kryesorë të hulumtimit.

Rezultatet e hulumtimit

Hulumtimi im ka rikonfirmuar se liria e medieeve në Kosovë është duke u përkeqësuar. Në krahasim me vitin e kaluar, Organizata Freedom House, këtë vit Kosovën e radhitë në dy vende më poshtë sa i përket lirisë së medias, në vendin e 100-të, në mesin e 199 vendeve.²

² Freedom of the press 2015, *HARSH LAWS AND VIOLENCE DRIVE GLOBAL DECLINE*, April 2015, 22

https://freedomhouse.org/sites/default/files/FreedomofthePress_2015_FINAL.pdf

Në Raportin e Grupit të Reporterëve pa Kufij, këtë vit Kosova është renditur në vendin e 87-të, në listën prej 180 vendesh, duke shënuar përkeqësim nga viti 2014, kur ka qenë në pozitën e 80-të.³

Fal zhvillimit të teknologjisë, informacionet sot publikohen shumë shpejt apo në çastin kur ndodhin, ato publikohen në rrjete sociale sidomos nga njerëz të rëndomtë. Ndërkaq, në medie informacioni jepet me censurë, madje deri në atë masë sa gazetarët nga frika dhe presioni që mund të kenë bëjnë autocenzurë, e cila është edhe më e rrezikshme.

Ky konstatim ka dalë edhe nga ky hulumtim, ku shumica e gazetarëve fillimisht thonë se janë plotësisht të lirë, kurse në pyetjen e radhës se: **Kush janë njerëzit me ndikim në politikën redaktuese të mediumit tuaj?**, thonë se janë **“njerëz të ndonjë grupi të interesit ose të afërt me ndonjë grup të interesit”**. Kjo situatë është paradoksale, sepse në rast se janë **plotësisht të lirë**, nuk do të duhej të plotësohej fare pyetja e radhës.




Fig. 1. A jeni të lirë ta ushtroni profesionin tuaj në mënyrë të pavarur?

Kjo situatë lë të kuptosh se fillimisht vetë gazetarët kanë treguar një kufizim, e në pyetjet e mëposhtme kanë dhënë përgjigje që tregojnë një situatë më reale në mediet në Kosovë.

³ Reporters Without Borders, 2015 World Press Freedom Index, Kosovo, (<http://index.rsrf.org/#/>)




Fig. 2. Kush janë njerëzit me ndikim në politikën redaktuese të mediumit tuaj?

Kufizimet dhe problemet e gazetarëve

Në këtë hulumtim shumica e gazetarëve (40.62%) kanë thënë se rrallë përballen me ndërhyrje në punën e tyre, por është paradoksale se përqindje e lartë e përgjigjeve ka dalë më poshtë kur thonë se kryeredaktori është ai që ndërhyr, madje edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë, në formë të udhëzimeve, këshillimeve apo edhe i urdhëron gazetarët.




Fig. 3. Kush dhe si ndërhyjnë në punën tuaj?

Justifikimi i shefave në medie për ndërhyrjen në punën e gazetarëve thuhet të jetë në emër të interesit të mediumit (49.37 %), por edhe në emër të interesit publik (44.37%). Sipas hulumtimit,

gazetarët thonë se janë të detyruar të pranojnë disa herë ndërhyrjet në punën e tyre, sidomos nga frika që mbeten pa punë.




Fig. 4. Përse i pranoni ndërhyrjet në punën tuaj?

Kërcënimet e shpeshta të gazetarëve janë shkak kryesor që gazetarët kufizohen të kryejnë punën e tyre. Në këtë hulumtim ka dalë që 35.62 % e gazetarëve thonë se janë të kërcënuar nga jashtë herë pas here, dhe forma më e shpeshtë e kërcënimit është përmes telefonit dhe postës elektronike, por ka raste edhe të kërcënimeve verbale, apo edhe përmes personave të tretë.




Fig. 5. Në çfarë formë jeni kërcënuar?

Sipas Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës vitin e kaluar kanë qenë 24 raste të raportuara të gazetarëve të kërcënuar apo që janë penguar në punën e tyre, ndërsa prej janarit deri në prill 2015 janë 10 raste të tilla. Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës ka tërhequr vërejtjen disa herë për kërcënime të gazetarëve, ose për cenim të punës së tyre,

por nuk është raportuar asnjëherë rezultati i atij reagimi apo raportimi publik.

Transmetuesi publik (RTK)

Kohëve të fundit kanë dalë në pah shqetësime të shumë gazetarëve të RTK-së rreth kufizimeve që kanë në ushtrimin e profesionit. Shqetësimet e tyre janë shprehur edhe me deklarata publike, madje edhe me protesta. Edhe në këtë hulumtim, shumica e gazetarëve të anketuar të transmetuesit publik (Radio Televizioni I Kosovës-RTK) janë deklaruar se janë pjesërisht të lirë (63.3%).




Fig. 6. A jeni të lirë ta ushtroni profesionin tuaj në mënyrë të pavarur (RTK)?

Ndërkaq, 43.3 % e gazetarëve të RTK-së kanë thënë se përballen me ndërhyrje në punën e tyre dhe atë nga drejtori, kryeredaktori, redaktori.




Fig. 7. Kush ndërhyr në punën tuaj?

Njerëz me ndikim në politikën redaktuese të RTK-së, sipas gazetarëve të anketuar të këtij mediumi janë: njerëz të pushtetit ose të afërt me pushtetin, njerëz të ndonjë partie politike apo të afërt me ndonjë parti politike, njerëz të ndonjë grupi të interesit ose të afërt me ndonjë grup të interesit.




Fig. 8. Kush janë njerëzit me ndikim në politikën redaktuese të mediumit tuaj?

Sipas Freedom House, në vendet e Ballkanit perëndimor, ku gjithashtu gjendja është e keqe, mediet publike janë të prira të jenë proqeveritare dhe ato janë të varura shumë nga pushteti. Por, sipas raportit, presioni editorial në medien publike nga njerëz të pushtetit dhe të bizneseve bën që të ketë më shumë vetëcensurë nga gazetarët.⁴ Kjo është e kuptueshme në një masë, sepse shumica e gazetarëve mbajnë familjet me atë punë.

45% e gazetarëve të anketuar në transmetuesin publik janë deklaruar se i pranojnë ndërhyrjet në punën e tyre, nga frika se

⁴ Freedom of the press 2015, *HARSH LAWS AND VIOLENCE DRIVE GLOBAL DECLINE*, April 2015, 7.

(https://freedomhouse.org/sites/default/files/FreedomofthePress_2015_FINAL.pdf, (parë për herë të fundit më 07/05/2015))

mbeten pa punë. Ndërkaq, justifikimi për ndërhyrje thuhet se bëhet në emër të mediumit (55%) dhe në emër të interesit publik (41.6%).

Kontrolluesit e medieve

Kontrolli i medieve shtetërore e dobëson ose e pengon zhvillimin e institucioneve demokratike.⁵ Por, edhe mediet private kontrollohen nga financuesit e tyre, biznese dhe individë të grupeve të ndryshme të interesit. 54 % e gazetarëve të intervistuar në mediet private kanë thënë se politikën redaktuese e diktojnë njerëz të ndonjë grupi të interesit ose të afërt me ndonjë grup të interesit.

Dy forma të trysnisë së tërthortë, që përdoren për të ushtruar kontroll mbi mediet janë reklamat dhe fondet nga qeveria.⁶

Edhe Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës e ka ngritur si shqetësim kufizimin e lirisë së medieve për shkak të mënyrës së financimit të tyre. Liria e shtypit në Kosovë është në pozitë të keqe dhe qeveria është cenuesi më i madh i lirisë së shprehjes, thuhet në një raport të këtij Asociacioni. Varshmëria financiare e medieve është duke e ngulfatur lirinë e shtypit, thuhet në raportin e AGK.⁷ Kujtoj pjesë nga një ligjëratë e gazetarit të njohur italian Indro Montanelli, të mbajtur në Universitetin e Torinos, më 12 maj 1997: “Nëse doni të ushtroni këtë zanat, kujtohuni mirë. Është një zanat që kërkon shumë përulesi... Një gazetë që duhet t’i kërkojë dikujt para, është pa dashje shërbëtor i punëve të tij.”⁸

⁵ Monro E. Prajs, Monroe E. Price, Peter Krug, *Ambienti i përshtatshëm për mediat e lira dhe të pavarura*, përkth. Naile Mala-Imami (Tiranë: 2002)

⁶ IREX. *The Development of Sustainable Independent Media in Europe and Eurasia*, 2013, f. 95

⁷ Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, *Raport për lirinë e shtypit në Kosovë*, Prishtinë, maj 2011

⁸ *Gazeta 55*, *Çfarë është dhe çfarë nuk është gazetaria*, 23.04.2009, (<http://gazeta55.al/cfare-eshte-dhe-cfare-nuk-eshte-gazetaria/>, parë për herë të fundit më 04/05/2015)

Korniza ligjore

Sundimi i ligjit në Kosovë, paraqet sfidë të veçantë për gazetarët dhe lirinë e medias. Zbatimi i legjislacionit është problem edhe në fushën e medias. Janë raste të pakta që mund të jenë kryer nga gjykatat,⁹ derisa janë proceduar disa ankesa dhe kallxime penale nga gazetarët të kërcënuar e të shantazhuar gjatë punës së tyre.

Edhe ligji i punës nuk zbatohet dhe kjo paraqet problem të veçantë për gazetarët sidomos tek ata në mediet private.¹⁰ Madje shumë gazetarë të medieeve punojnë edhe pa kontratë pune.

Ligji për RTK-në vendos një bazë të mirë për të siguruar funksionimin e këtij institucioni në shërbim të interesit publik të Kosovës, pa rënë nën ndikimin e politikës dhe në përputhje me praktikat më të mira të BE-së. Por, ka pasur shumë vërejtje, sidomos kohëve të fundit që është shkelur ligji sa i përket lirisë së veprimt të gazetarëve.¹¹

Disa shembuj:

- *Ndërhyrja e redaktorit përgjegjës të Televizionit të Kosovës për heqjen e lajmit për reagimin e kryeministrit lidhur me zgjedhjen e drejtorit të ri të PTK-së, me arsyetimin se kryeministri paska shkelur ligjin. (Më 20.02.2015).*

- *Heqja e deklaratës së këshilltares komunale të Skenderajt në ceremoninë e inaugurimit të kryetarit të ri të komunës, vetëm pse kishte mendim ndryshe. (Më 03.01.2014).*

- *Prezantimi në lajmet qendrore i rezultateve të një sondazhi i cili favorizonte një subjekt politik. Sondazh pa emër, pa mostër, pa adresë dhe e tërë kjo në prag të zgjedhjeve, diçka që ndalohet me standardet profesionale të RTK-së. (Më 17.04.2014).*

⁹ Zëri, 'Arbana Xharra mund Zhugollin edhe në Gjykatën e Apelit', Prishtinë, 26 shkurt 2015 (<http://www.zeri.info/kronika/21461/arbana-xharra-mund-zhugollin-edhe-ne-gjykatën-e-apelit/>)

¹⁰ OSBE, Liria e mediave dhe siguria e gazetarëve në Kosovë, raport, qershor 2014

¹¹ Deklaratë kundër cenzurës e redaktorëve dhe gazetarëve të RTK-së, Prishtinë, prill 2015

- *Ndërprerja në gjysmë e edicionit të lajmeve të orës 23:00, vetëm për shkak se nuk kishte një lajm për një politikan. (Më 19.01.2015).*

- *Më datën 06.02.2014, drejtori gjeneral ka shkarkuar nga detyra redaktorin përgjegjës të aktualiteteve, pasi që në emisionin Debat kishte zhvilluar një intervistë me një politikan opozitar.*

Për këto zhvillime në RTK ka pasur një reagim edhe nga Komisionari për Politika Evropiane të Fqinjësisë dhe Negociatat e Zgjerimit, Johannes Hahn. Ai ka reaguar kundër shkeljeve të të drejtave të gazetarëve të RTK-së dhe ushtrimit të profesionit të tyre në mënyrë të pavarur, përmes një letre që i ka dërguar Bordit të Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës.¹²

Kushtetuta e Kosovës është korniza më e rëndësishme ligjore e cila siguron lirinë e fjalës dhe shprehjes në Kosovë, e cila është miratuar pas shpalljes së Pavarësisë, në vitin 2008. Me kushtetutën e Kosovës, garantohet liria dhe pluralizmi i medieve. Ndërkaq, censura është e ndaluar.¹³

Shkalla e lirisë së medieve në Kosovë është kritikuar edhe nga Raportet e progresit të Komisionit Evropian, ku vazhdimisht iu kërkohet institucioneve që të marrin masa për ndalimin e kërcënimeve ndaj gazetarëve. Raportet e progresit për Kosovën rikujtojnë që liria e medieve garantohet me ligj dhe bëjnë thirrje për përpjekje më të mëdha në terren, siç janë hetimi dhe ndjekja penale e sulmeve fizike ndaj gazetarëve, si dhe për ndryshimin e dispozitave të Kodit Penal në lidhje me përgjegjësinë penale të medieve dhe mbrojtjen e burimeve të gazetarisë.¹⁴

Përfundimi

Gazetaria në Kosovë është në gjendje të dobët, për shkak të kufizimit të lirisë së shumë gazetarëve që punojnë në medie të ndryshme. Rezultatet e këtij hulumtimi tregojnë se gazetarët në redaksitë ku

¹² Hahn, JOHANNES, MEMBER OF THE EUROPEAN COMMISSION, Brussel, maj 2015 (<http://politiko.net/wp-content/uploads/2015/05/Letra.pdf>, (parë për herë të fundit më 08.05.2015)

¹³ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 42 Liria e Medieve, 2008, 13

¹⁴ European Commission, Kosovo, 2014 Progress Report, 2014, Brussels, 24

punojnë janë të kufizuar dhe të ndikuar nga shumë faktorë. Mbi 50% thonë se kanë dilema nëse do ta vazhdojnë profesionin e gazetarisë, për shkak se ndjehen të rrezikuar nga presioni dhe kërcënimet që marrin.

Mund të përmend se gazetarë të një redaksie nuk i janë përgjigjur asnjë pyetësori të këtij hulumtimi dhe kjo më bën të dyshoj për probleme eventuale që do të mund të kishin ata me pronarin. Ajo gazetë nuk ka ekskluzivitet, përveç ngjarje dite dhe tema dhe intervista të porositura nga eprorët.

Ekziston rreziku që gjendja e gazetarisë dhe e raportimit të përkeqësohet edhe më shumë për shkak të pozitës së pafavorshme të gazetarëve. Në Kosovë ka shumë gazetarë të dalluar dhe të zotë në profesionin e tyre. Shumë prej tyre kanë fituar çmime ndërkombëtare në gara më të mëdha me gazetarë të botës. Por, dekurajimi dhe presioni i vazhdueshëm, bën që ata dhe gazetarë të rinj të mos merren me gazetarinë e mirëfilltë, apo gazetarinë hulumtuese që është çelës në këtë profesion.

Rekomandime

Institucionet dhe organizatat e medieve duhet të shqyrtojnë me shpejtësi shkallën e ndikimit që iu bëhet gazetarëve, qoftë në medien publike apo në ato private.

E konsideroj me interes ngritjen e zërit të gazetarëve për të drejta në punë, sepse tash për tash mbi 38% e të anketuarve thonë se frikësohen që mbeten pa punë, në qoftë se nuk i pranojnë ndërhyrjet nga udhëheqësit e medias ku punojnë, apo edhe nga faktorë të jashtëm.

Udhëheqësit e medieve duhet të kërkojnë më shumë mundësi alternative financimi në mënyrë që të mos të ndikohen nga politika, njerëz dhe grupe të interesit.

Është e nevojshme të krijohet hapësirë për punë të pavarur të gazetarëve dhe të luftohet fenomeni i ndikimit nga të tjerët, me një strategji afatgjate nga institucionet e Kosovës.

Literatura

1. Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, Raport për lirinë e shtypit në Kosovë, Prishtinë, 2011
3. Council of the European Union, EU Human Rights Guidelines on Freedom of Expression Online and Offline, Bussel, 2014
2. Deklaratë kundër censurës e redaktorëve dhe gazetarëve të RTK-së, Prishtinë, 2015
3. European Commission, Kosovo, 2014 Progress Report, Brussels, 2014
4. Freedom of the press 2015, Harsh Laws and Violence Drive Global Decline, Aprill 2015
5. Gazeta 55, Çfarë është dhe çfarë nuk është gazetaria, 23.04.2009, <http://gazeta55.al/cfare-eshte-dhe-cfare-nuk-eshte-gazetaria/> (parë për herë të fundit më 04/05/2015)
6. IREX. The Development of Sustainable Independent Media in Europe and Eurasia, 2013
7. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 42 Liria e Medieve, 2008
8. Monro E. Prajs, Monroe E. Price, Peter Krug., *Ambienti i përshtatshëm për mediat e lira dhe të pavarura, përkth. Naile Mala-Imami, Tiranë: 2002)*
9. OSBE, Liria e medieve dhe siguria e gazetarëve në Kosovë, raport, qershor 2014
10. Reporters Without Borders, 2015 World Press Freedom Index, Kosovo, <http://index.rsf.org/#!/> (parë për herë të fundit më 05/05/2015).